



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:259225

Datë: 18.06.2024

Numri i dokumentit: 05830769

KE.nr. 634/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen juridike të paditësit “Kosovarja” Shitorja nr.33 me seli në Prishtinë, me pronar SH.M., kundër të paditurës KES/CO – Departamenti për Konsumatorë me seli në Prishtinë jashtë seancës gjyqësore, me datë 18.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Gjykata Komercale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë- Departamenti për Çështje Ekonomike shpallet JO KOMPETENTE NË PIKËPAMJE GJYQËSORE për të vendosur sipas padisë së paditësit “Kosovarja” Shitorja nr.33 me seli në Prishtinë, me pronar SH.M., kundër të paditurës KES/CO – Departamenti për Konsumatorë, me objekt kontesti anulim i faturës dhe rikthim i humbjeve.
- II. SHPALLEN TË PAVLEFSHME të gjitha veprimet procedurale te kryera nga gjykata në këtë çështje kontestimore.
- III. HUDHET POSHTË si e palejuar padia paditësit “Kosovarja” Shitorja nr.33 me seli në Prishtinë, me pronar SH.M., kundër të paditurës KES/CO – Departamenti për Konsumatorë, me objekt kontesti anulim i faturës dhe rikthim i humbjeve.
- IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi Ndërmarrja Tregtare “Kosovarja” Shitorja nr.33 me seli në Prishtinë, me datë 27.04.2018 ka paraqitur padi ndaj të paditurës KES/CO – Departamenti për Konsumatorë me seli në Prishtinë, me objekt kontesti anulim i faturës dhe rikthim i humbjeve.

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, me aktvendimin A.nr.1093/18, të dt.20.12.2019, është shpallur jo-kompetente në pikëpamje lëndore për vendosjen e kësaj çështje dhe ka vendosur që pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi lënda me të gjitha shkresat të dërgohet në Departamentin e Përgjithshëm të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Ndërsa, me hyrjen në fuqi të Ligjit për Gjykatën Komerciale, lënda në fjalë, në bazë të kompetencës lëndore, është transferuar për shqyrtim të mëtutjeshëm pranë Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike.

Kjo Gjykatë, me rastin e shqyrtimit të kësaj çështje, në kuptim të dispozitës së nenit 18 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se gjykata, sipas detyrës zyrtare gjatë gjithë procedurës kujdeset nëse zgjidhja e kontestit hynë në kompetencë gjyqësore, erdhi në përfundim se për vendosjen e kësaj çështje i mungon kompetenca gjyqësore, pasi që për vendosjen e këtij kontesti kompetent është organi administrativ, respektivisht Zyra e Rregullatorit për Energji, për arsyet si në vijim:

Gjykata iu referua Ligjit Nr.03/L-185 për Rregullatorin e Energjisë, ku në nenin 16 par.1 pika 3 përcaktohet se: *“Zyra e Rregullatorit për Energji ka kompetencë për zgjidhjen e të gjitha kontesteve në sektorin e energjisë, përfshirë edhe ankesat në lidhje me qasjen e palës së tretë në sistemin e transmisionit apo shpërndarjes së energjisë elektrike.”* Dispozita e nenit 25 par.1 e të njëjtit ligj përcakton që: *“Zyra e Rregullatorit për Energji ka kompetencë që të nxjerrë vendime për zgjidhjen e kontesteve sipas nenit 16 të këtij ligji.”*

Sipas nenit 25 par.3 të po këtij ligji, është paraparë që *“Aktet individuale të lëshuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji në bazë të paragrafit 1 të këtij neni, i nënshtrohen procedurave të shqyrtimit administrativ brenda Zyrës së Rregullatorit për Energji. Pas përfundimit të procedurës së shqyrtimit administrativ, pala e pakënaqur mund të fillojë procedurën administrative për zgjidhjen e kontestit pranë gjykatës kompetente, në pajtim me nenin 43 të këtij Ligji dhe me Ligjin për Procedurën Administrative.”*

Po ashtu, duke iu referuar Rregullit për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë, të hartuar nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë me datën 29.08.2011, në nenin 18 pika 5 është paraparë se: *“kundër vendimeve të Bordit të ZRRE-së, konsumatorët apo të licencuarit mund të iniciojnë konflikt administrativ në gjykatën kompetente brenda 30 ditësh kalendarike nga data e pranimit të vendimit apo publikimit në faqen zyrtare elektronike të ZRRE-së.”*

Në rastin konkret, paditësi në petitum të kërkesëpadisë ka kërkuar shfuqizimin e faturës për rikthimin e humbjeve ..., si dhe të detyrohet e paditura që borxhin në shumë prej 1,558.83 Euro ta shlyejë nga evidenca e borxheve. Gjykata vëren se paditësi lidhur me një kërkesë të tillë i është drejtuar të paditurës, me ç ‘rast e njëjta, me vendimin e datës 11.04.2018 përmes Departamentit për Konsumatorë, duke iu referuar pikërisht kreut III të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë, e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e paditësit.

Në prani të këtyre rrethanave, e në kuptim të dispozitave të cituara më lartë, kjo Gjykatë vlerëson se paditësi, lidhur me të drejtën e pretenduar, për zgjidhjen e kontestit është dashur t’i drejtohet organit shtetëror administrativ, gjegjësisht Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, duke i ndjekur procedurat e parapara me legjislacionin përkatës, e jo të kërkojë mbrojtje gjyqësore përmes ushtrimit të padisë në procedurë kontestimore, për faktin se lidhur me kontestin e natyrës së tillë, kësaj Gjykate i mungon kompetenca gjyqësore për çështjen e ngritur me padi.

Në këtë mënyrë, Gjykata vlerëson se janë plotësuar prezumimet procedurale që të vepohet në kuptim të dispozitës së nenit 18 par.2 të LPK-së, e cila përcakton që *“Kur gjykata gjatë procedimit të çështjes konstaton se për zgjidhjen e kontestit nuk është kompetente gjykata veçse ndonjë organ shtetëror tjetër, do të shpallet inkompetente, do t’i shpallë të pavlefshme të gjitha veprimet procedurale të kryera dhe do ta hedhë poshtë padinë që i është paraqitur”*. Lidhur me këtë, dispozita e nenit 391 pika a) përcakton: *“Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se: a) çështja e ngritur me padi nuk hynë në kompetencën gjyqësore”*.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës, nga pika IV të dispozitivit të këtij aktvendimi, Gjykata e mbështeti në dispozitën nga neni 450 të LPK-së.

Mbi bazën e të lartcekurave, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr. 634/22, datë 18.06.2024

Gjyqtari  
Florent Zeqiri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.